



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

### VENDIM

Nr. 25, datë 14.01.2020

### PËR

### SHPALLJEN E POZICIONEVE TË LIRA PËR GJYQTARËT E EMËRUAR MË DATË 09.01.2020

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147, pika 1 dhe nenin 147/a, pika 1, shkronja “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 39, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 25, pika 2, të Ligjit nr. 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në konsideratë të përcaktimeve të nenit 15, pika 4, shkronja “a” dhe të nenit 90, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, duke mbajtur parasysh numrin e gjyqtarëve të emëruar më datë 09.01.2020 dhe pozicionet e lira në sistemin gjyqësor në gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm dhe atë administrativ, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

### VENDOSI:

1. Shpalljen e pozicioneve të lira për të diplomuarit në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2018-2019 dhe të emëruar gjyqtarë më datë 09.01.2020.
2. Pozicionet e lira janë si më poshtë :
  - a) **dy** pozicione në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë;
  - b) **dy** pozicione në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë;
  - c) **dy** pozicione në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër;
  - ç) **një** pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat;
  - d) **një** pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër;
  - dh) **një** pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier;
  - e) **një** pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë;
  - ë) **një** pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë;
  - f) **një** pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës;
  - g) **një** pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec;
  - gj) **një** pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë;
  - h) **një** pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.
3. Të emëruarit sipas pikës 1 të këtij vendimi kanë të drejtë të përcaktojnë, sipas renditjes preferenciale, tri gjykata nga ato sipas pikës 2 të këtij vendimi, në të cilat ata kërkojnë të caktohen.
4. Të emëruarit sipas pikës 1 të këtij vendimi kanë detyrimin të deklarojnë situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të nenit 8, pika 3, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

5. Afati i aplikimit është deri më datë 21.01.2020. Mungesa e aplikimit nuk passjell ndalimin e procedurës së caktimit në pozicion të të emëruarve.
6. Në momentin e aplikimit të emëruarit sipas pikës 1 të këtij vendimi duhet të dorëzojnë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor këto dokumente:
  - a) Një deklaratë me shkrim ku përcakton, sipas renditjes preferenciale, tri gjykata nga ato sipas pikës 2 të këtij vendimi, në të cilat kërkon të caktohet.
  - b) Një vetëdeklarim me shkrim, sipas Shtojcës së këtij vendimi, ku të deklarojë nëse ndodhet apo jo në një nga rastet e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të nenit 8, pika 3, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

### **SHTOJCË**

#### **VETËDEKLARIM**

#### **PËR SITUATËN E PAPAJTUESHMËRISË AMBIENTALE**

Unë gjyqtari/ja \_\_\_\_\_ (*emër, atësia, mbiemri*), i emëruar me Vendimin nr. \_\_\_\_, datë 09.01.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në përmbushje të detyrimit të përcaktuar në nenin 8,

pika 5, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore,

**DEKLAROJ SE:**

**Nuk do të ndodhem në situatën papajtueshmërisë ambientale**, sipas nenit 8, pika 3, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në rastin e caktimit në një prej gjykatave të shkallës së parë të shpallura me Vendimin nr.25, datë 14.01.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Lëshuar më \_\_\_\_01.2020**

**DEKLARUESI**

---

*(Emri, atësia, mbiemri)*  
*(Nënshkrimi)*

**VETËDEKLARIM**

**PËR SITUATËN E PAPAJTUESHMËRISË AMBIENTALE**

Unë gjyqtari/ja \_\_\_\_\_ (*emër, atësia, mbiemri*), i emëruar me Vendimin nr.\_\_\_\_, datë 09.01.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në përmbushje të detyrimit të përcaktuar në nenin 8, pika 5, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore,

## DEKLAROJ SE:

Do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale, sipas nenit 8, pika 3, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në rast të caktimit në këto gjykata të shkallës së parë të shpallura me Vendimin nr.25, datë 14.01.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë \_\_\_\_\_ (Gjirokastrë / Korçë / Shkodër), për shkak të lidhjeve të ngushta familjare, qenies \_\_\_\_\_ (bashkëshort, bashkëjetues ose i afërt në shkallë të parë/të dytë), me gjyqtarin \_\_\_\_\_ (emër, mbiemër), që ushtron funksionin në Gjykatën Administrative të Apelit.
2. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor \_\_\_\_\_ (Berat / Dibër / Korçë / Krujë / Kukës / Pogradec / Sarandë), për shkak të lidhjeve të ngushta familjare, qenies \_\_\_\_\_ (bashkëshort, bashkëjetues ose i afërt në shkallë të parë/të dytë), me gjyqtarin \_\_\_\_\_ (emër, mbiemër), që ushtron funksionin në këtë Gjykatë / me prokurorin \_\_\_\_\_ (emër, mbiemër), që ushtron funksionin në Prokurorisë pranë kësaj Gjykate / me gjyqtarin \_\_\_\_\_ (emër, mbiemër), që ushtron funksionin në Gjykatën e Apelit \_\_\_\_\_, që ka nën juridiksion këtë Gjykatë / me prokurorin \_\_\_\_\_ (emër, mbiemër), që ushtron funksionin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit \_\_\_\_\_, që ka nën juridiksion këtë Gjykatë.
3. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor \_\_\_\_\_ (Fier / Shkodër), Seksioni Civil, për shkak të lidhjeve të ngushta familjare, qenies \_\_\_\_\_ (bashkëshort, bashkëjetues ose i afërt në shkallë të parë/të dytë), me gjyqtarin \_\_\_\_\_ (emër, mbiemër), që ushtron funksionin në Seksionin Civil të Gjykatës së Apelit \_\_\_\_\_, që ka nën juridiksion këtë Gjykatë.
4. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor \_\_\_\_\_ (Fier / Shkodër), Seksioni Penal, për shkak të lidhjeve të ngushta familjare, qenies \_\_\_\_\_ (bashkëshort, bashkëjetues ose i afërt në shkallë të parë/të dytë), me gjyqtarin \_\_\_\_\_ (emër, mbiemër), që ushtron funksionin në Seksionin Penal të Gjykatës së Apelit \_\_\_\_\_, që ka nën juridiksion këtë Gjykatë / me prokurorin \_\_\_\_\_ (emër, mbiemër), që ushtron funksionin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit \_\_\_\_\_, që ka nën juridiksion këtë Gjykatë.

Lëshuar më \_\_.01.2020

## DEKLARUESI

---

(Emri, atësia, mbiemri)  
(Nënshkrimi)